



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 630, datë 10.12.2020**

**PËR**  
**ZBATIMIN E VENDIMIT NR.93, DATË 10.11.2020, TË GJYKATËS**  
**ADMINISTRATIVE TË APELIT DHE FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT**  
**TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN E**  
**LARTË, PËR KANDIDATEN ZNJ.{...}, PËR TRE NGA KATËR POZICIONET E LIRA**  
**NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR.241,**  
**NR.242, NR.243 DHE NR.244, DATË 09.07.2020,**  
**TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 136 dhe 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 85, pikat 2 e 3 dhe nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni A, pika 1, shkronja “c” dhe pika 2, si dhe në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, në zbatim të Vendimit nr.93, datë 10.11.2020, të Gjykatës Administrative të Apelit,

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidaten znj. {...}, për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Procedura e verifikimit të kandidatës, përfshirë edhe sa i përket pasurisë dhe figurës, e realizuar për kandidimet e saj të mëparshme, është e vlefshme edhe për kandidimet e saj për tre nga katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale në Gjykatën e Lartë, të shpallura me Vendimet nr.241, nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**